



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURENCËS**  
**DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE**

**NJOFTIM**

**Rasti:** Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Saudi Aramco Development Co Ltd dhe Honeywell Automation and Control Products Ltd.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni që synon krijimin e një ndërmarrje të përbashkët / joint-venture, me funksione të plota, nga shoqëritë Saudi Aramco Development Co Ltd dhe Honeywell Automation and Control Products Ltd.

Referuar “Marrëveshje ortakësh”, palët janë:

**Pala 1:** Saudi Aramco Development Co Ltd është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin e Mbretërisë së Arabisë Saudite, e angazhuar në furnizimin dhe tregtimin e naftës, gazit, petrokimike, shërbimet komunale dhe furnizime industriale.

Saudi Aramco Development Co Ltd është një filial në pronësi të plotë të shoqërisë Saudi Arabian Oil Company. Saudi Arabian Oil Company nuk ka prezencë ligjore të regjistruar në Shqipëri, por gjeneron të ardhura përmes tregtimit dhe shitjes së hidrokarbureve dhe lëndëve të tjera derivate.

**Pala 2:** Honeywell Automation and Control Products Ltd është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin e Mbretërisë së Arabisë Saudite,

Honeywell Automation and Control Products Ltd është një filial në pronësi të plotë të Honeywell International Inc., një konglomerat shumëkombësh, i listuar në bursë në SHBA.

Pala njoftuese nuk ka depozituar informacion mbi ndonjë filial apo degë të Honeywell International Inc. në Shqipëri, por ka deklaruar që realizon të ardhura.

**Ndërmarrja e Përbashkët (JV)**, do të themelohet në Mbretërinë e Arabisë Saudite dhe do të jetë një JV me funksion të plotë, aktive në zhvillimin, vendosjen, tregtimin dhe menaxhimin e Plant Digital Platforms.

Aktualisht nuk ka plane që Joint Venture e propozuar të jetë aktive, apo të ushtrojë aktivitet në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**